

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" Fidem Group Albania " SH.P.K

Sot, më datë 04.11.2024,

Kristian Gjoni, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 20/03/1991, lindur në Lezhë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BG7701138 dhe Nr. Personal J10320064J zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% të kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është "**Fidem Group Albania**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Fidem Group Albania**" Sh.P.K.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objekti i shoqërisë do jetë:

Prodhimin dhe tregtimin e dyerve plastike, dritareve, skeleteve, grilave, mbajtëseve të plintave, dysHEMEVE plastike, mureve ose tavane prej plastike në forma të petëzuar apo në formë tullash etj. Prodhim dhe tregtim për pajisje sanitare plastike si banjat, kabinat e dushit, vaska, lavaman, cisterna etj. Prodhim dhe tregtim të mbulesave të dysHemesë plastike si linoleum, vinil etj. Prodhim dhe tregtim të gurëve artificial, të dyerve metalike, dritareve dhe skeletet e tyre, qepenëve dhe kangjellave, ndarjen e dhomave metalike për shtojcat e apartamenteve, prodhimin e kasafortave, kutiave të forta, dyer të blinduara. Punime që kontribuojnë në përfundimin e ndërtimit si veshja me xham etj. Montime të fasadave prej xhami. Montime të dritareve dhe dyerve brenda dhe jashtë vendit. Transport ndërkombëtar për të trete dhe me qira. Tregti automjete të reja dhe të përdorura. Aktivitete të ndërtimit të ndërtësive industriale dhe civile, rindërtimi dhe rinovimi. Shërbime marketingu. Shërbime konsulence në fushën e ngritjes dhe zhvillimit të kompanive prodhuese.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Fidem Group Albania**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Prodhimin dhe tregtimin e dyerve plastike, dritareve, skeleteve, grilave, mbajtëseve të plintave, dysHEMEVE plastike, mureve ose tavane prej plastike në forma të petëzuar apo në formë tullash etj. Prodhim dhe tregtim për pajisje sanitare



plastike si banjat, kabinat e dushit, vaska, lavaman, cisterna etj. Prodhim dhe tregtim te mbulesave të dyshemesë plastike si linoleum, vinil etj. Prodhim dhe tregtim te gurëve artificial, te dyerve metalike, dritareve dhe skeletet e tyre, qepenëve dhe kangjellave, ndarjen e dhomave metalike për shtojcat e apartamenteve, prodhimin e kasafortave, kutiave të forta, dyer të blinduara. Punime qe kontribuojne ne perfundimin e ndertimit si veshja me xham etj. Montime te fasadave prej xhami. Montime te dritareve dhe dyerve brenda dhe jashte vendit. Transport nderkombetar per te trete dhe me qira. Tregti automjete te reja dhe te perdorura. Aktivitete te ndertimit te ndertesave industriale dhe civile, rindërtimi dhe rinovimi. Sherbime marketingu. Sherbime konsulence ne fushen e ngritjes dhe zhvillimit te kompanive prodhuese.

NENI 5

Selia e Shoqerisë dhe Afati

Selia e Shoqerisë ndodhet në qytetin e Shkodres me adresë; Bashkia Vau Dejes, Njesia Bashkiake Shelqet, Fshati Kosmac, Nr.Pasurise:225/17, Zona Kadastrale: 2236. (Pjesa e pasme e ndertesës).

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali i Shoqerisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqerisë është në vlerën **2,000,000** (Dy milion) lekë, i ndarë në 1 kuotë ku kuota ka vlerën 2.000,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin **“Fidem Group Albania” Sh.P.K** zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Kristian Gjoni, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 20/03/1991, lindur në Lezhë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BG7701138 dhe Nr. Personal J10320064J zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, ku një kuotë ka vlerën 2,000,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqerisë.



NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet Z. **Kristian Gjoni**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 20/03/1991, lindur në Lezhë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BG7701138 dhe Nr. Personal *J10320064J* me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi te kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Kristjan Gjoni

KRISTIAN GJONI

